




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE VLORË
SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE



KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Ministria e Kulturës, Nr. Prot. 1862/, Data 18.01.2023

Shkurtimi i lëndës Mbrojtja e Shprehjes së Artit dhe Kulturës N=255 dt 29.4.2023
si Mbrojtja e Kulturës

Për trajtim nga :	<u>Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse</u>
(struktura të tjera të ngarkuara	<u>2. Anton Bollë</u>
Me porosi:	<u>Është nderfjetur</u>

Afati : ☐ Normal 7 ditë/ ☐ Prioritet 3 ditë/ ☐ urgjent brenda ditës/ ☒ pa afat/për dije/tjetër _____ ditë

Data 22.5.2023, Nr. Prot. 139/2, Nënshkrimi : (TITULLARI)

Marrë në dorëzim : _____, 2023 Nënshkrimi : _____
Kalon për trajtim (struktura) : _____, 2023
Me porosinë : _____


Marrë në dorëzim : _____, 2023 Nënshkrimi : _____
Kalon për trajtim (struktura) : _____, 2023
Me porosinë : _____

Marrë në dorëzim : _____, 2023 Nënshkrimi : _____
Kalon për trajtim Specialistit : _____, 2023
Me porosinë : _____

Trajtimi i materialit përfunduar më : _____, 2023 Specialisti
Trajtimi i materialit pranuar më : _____, 2023 Eprori në shkallë hierarkike
Trajtimi i materialit miratuar më : _____, 2023 Eprori në shkallë hierarkike
Trajtimi i materialit miratuar më : _____, 2023 Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



Nr. 1962/4 prot.

Eprit/prodhollues-ny.
Ju.

Tiranë, më 18.5.2023

Lënda: Për njohje dhe zbatim Statuti i DRTK Vlorë

Z. ORGES FEIMI, DREJTOR
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE VLORË ✓
Adresa: lagja "Hajro Çakërr", nr. 56, Vlorë


I nderuar z. Feimi,

Në zbatim të ligjit nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Vendimit nr. 581, datë 28.8.2019 të Këshillit të Ministrave "Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore", ju përcjellim për njohje dhe zbatim Statutin e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë, miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 255, datë 24.4.2023.

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Zerina BRUCI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 1962 prot

Tiranë, më 24.4.2023

URDHËR

Nr. 255, datë 24.4.2023

PËR

MIRATIMIN E STATUTIT "DREJTORISË RAJONALE TË TRASHËGIMISË
KULTURORE VLORË"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 dhe nenit 119 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", vendimit nr. 581, datë 28.8.2019 të Këshillit të Ministrave "Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore", urdhrit të Kryeministrit nr. 139, datë 21.10.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohen punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë, për zbatimin e këtij Urdhri, si dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Kulturës për komunikimin e tij.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Elva Margariti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE VLORE

STATUTI

I

DREJTORISË RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE VLORE.

MIRATOI

MINISTËR

Elva Margariti






Tabela e Përmbajtjes

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....

Neni 1 Objekti.....4

Neni 2 Statusi.....4

Neni 3 Misioni..... 4

Neni 4 Parimet.....4

Neni 5 Stema, vula zyrtare dhe logoja.....5

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I DREJTORISË RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE VLORE

Neni 6 Struktura organizative.....5

Neni 7 Detyrat e DRTK.....5

Neni 8 Kompetencat e DRTK.....6

KREU III DREJTIMI, MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT, DHE DETYRAT E DREJTORIT.....

Neni 9
Drejtimi.....7

Neni 10 FunkSIONET E SEKTORËVE8

Neni 11 Marrëdhëniet e
punësimit.....9

KREU IV ADMINISTRIMI FINANCIAR.....

Neni 12 Të ardhurat
buxhetore.....9

Neni 13 Hartimi i projekt
buxhetit.....10

Neni 14 Auditimi
financiar.....10

KREU V DISPOZITA TË
FUNDIT.....

Neni 15 Ndryshimet në
Statut.....10

Neni 16 Hyrja në
fuqi.....10



KREU I

DISPOZOTA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky statut përcakton parimet bazë të procedurave institucionale, administrative dhe operative të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë (në vijim, DRTK Vlorë).

Neni 2

Statusi juridik

1. DRTK Vlorë, është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit 27/2018 *"Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"*, vendimit nr. 581, datë 28.8.2019 të Këshillit të Ministrave *"Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore"*, urdhrit të Kryeministrit nr. 139, datë 21.10.2019 *"Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore"*, dhe këtij statuti.
2. DRTK Vlorë është institucion rajonal i specializuar, tekniko-administrative buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore si dhe financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.
3. DRTK Vlorë e ushtron aktivitetin në mbështetje dhe në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të dispozitave e legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, këtij statuti si dhe të rregullores së brendshme të funksionimit të tij.

Neni 3

Misioni

DRTK Vlorë është institucion rajonal i specializuar tekniko-administrativ buxhetor që ushtron veprimtarinë e tij në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territoret si më poshtë:

- a) Në Bashkinë Vlorë;
- b) Në Bashkinë Himarë;
- c) Në Bashkinë Sarandë;
- d) Në Bashkinë Fier.

Neni 4

Parimet

DRTK Vlorë në veprimtarinë e tij udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, transparencës, profesionalizmit, cilësisë, eficiencës dhe efektivitetit të shërbimit, barazisë, mosdiskriminimit, parimin e mbrojtjes së të dhënave, ruajtjes së konfidencialitetit.

Neni 5

Selia, stema, vula dhe logoja

1. DRTK Vlorë identifikohet me stemën, vulën dhe logon e tij.
2. Logoja përfshin logon e DRTK Vlorë.
3. Stema e DRTK Vlorë përbëhet nga stema e Republikës me shënimet “Republika e Shqipërisë”, Ministria e Kulturës, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë”.
4. Vula e DRTK Vlorë prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. DRTK Vlorë e ka selinë në Vlorë, me adresë Lagja “Hajro Çakërr”, Nr.56 Vlorë.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 6

Struktura organizative

1. Struktura dhe organika e DRTK Vlorë organizohet dhe funksionon sipas strukturës dhe organikës të miratuar me urdhërin e Kryeministrit nr. 139, datë 21.10.2019 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore*”.
2. Struktura e DRTK Vlorë është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga pozicionet si vijon:
 - a) Drejtori (Titullari i institucionit);
 - b) Sektori i Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore Vlorë;
 - c) Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Vlorë;
 - d) Sektori i Himarës;
 - e) Sektori i Sarandës;
 - f) Sektori i Parqeve Amantia-Orikum-Finiq-Antigonea;
 - g) Sektori i Fierit.

Neni 7

Detyrat e DRTK Vlorë

1. Veprimtaria e DRTK-së Vlorë organizohet dhe realizohet përmes sektorëve të saj përbërës.
2. Në veprimtarinë dhe ushtrimin e funksioneve DRTK Vlorë, monitorohet dhe koordinohet nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

3. DRTK Vlorë zhvillon veprimtarinë e saj brenda sistemit të trashëgimisë kulturore kombëtare si dhe në kuadër të marrëdhënieve me partnerë, institucione dhe organizma ndërkombëtarë.
4. DRTK Vlorë anëtarësohet në organizma të përhershme, si dhe aktivizohet në organizma dhe veprimtari të përkohshme në fushën përkatëse, brenda ose jashtë vendit.
5. DRTK Vlorë në përputhje me misionin e vet, harton projekte të veçanta, sipas nevojave dhe prioriteteve.
6. DRTK Vlorë është institucion laik dhe i depolitizuar.
7. DRTK Vlorë, si person juridik, merr pjesë në veprimtaritë publike e private, brenda ose jashtëvendit, në ushtrim të funksioneve dhe në realizim të qëllimeve të saj të ligjshme

Neni 8

Kompetencat e DRTK Vlorë

DRTK Vlorë ka këto kompetenca:

- a) zbaton konventat ndërkombëtare të ratifikuara në Republikën e Shqipërisë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;
- b) gjurmon dhe përgatit vlerësime paraprake e gjithëpërfshirëse për deklarimin e interesit kulturor dhe dhënien e statusit të mbrojtjes;
- c) kryen verifikime sistematike për gjendjen e pasurive kulturore në territorin që administron, si dhe në bazë të kërkesave të paraqitura;
- d) kryen verifikime dhe merr masa, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 27/2018 "*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*", në raste të situatave emergjente, kur rrezikohet gjendja e pasurive kulturore;
- e) harton projekte konservimi, restaurimi, vlerësimi, projekte të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore dhe bashkërendon punën për zbatimin e tyre në nivel rajonal e vendor;
- f) kryen punime konservimi dhe restaurimi në pasuritë kulturore në bazë të projekteve të miratuara;
- g) kryen mbikëqyrjen dhe kolaudimin e zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale;
- h) Monitoron e administron Qendrën Historike Vlorë dhe siguron ruajtjen e vlerës së veçantë universale të saj;
- i) Harton Raporte periodike për gjendjen e konservimit të pasurisë botërore në zbatim të vendimeve të komitetit të Trashëgimisë Botërore;
- j) Kryen verifikime sistematike apo në bazë të kërkesave të paraqitura për gjendjen e pasurive kulturore në territorin që administron, si dhe ushtron kontrollin teknik për kushtet e ruajtjes së pasurive kulturore, duke përfshirë edhe fondet muzeore, si dhe të zonave që u nënshtrohen dispozitave të mbrojtjes indirekte;
- k) Kryen ndërhyrje, punime konservimi dhe restaurimi në pasuritë kulturore në bazë të projekteve të miratuara në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim, KKTKM);

- l) Kryen mbikëqyrjen dhe kolaudimin e zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale, në përputhje me vendimin e KKTKM-së;
- m) Merr në dorëzim punimet për ndërhyrjet në pasuritë kulturore të paluajtshme, përfshirë edhe tipologjitë e punimeve për konservim dhe restaurim fasade, konservim e restaurim të elementeve të brendshme artistike, ruajtje të vlerave arkeologjike kulturore;
- n) Mbi bazën e deklarimeve të marra nga mbajtësi i pasurisë kulturore, njofton IKRTK-në sipas parashikimeve të ligjit, në rast ndryshimi të vendndodhjes së pasurive kulturore të luajtshme, duke përfshirë edhe fondet muzeore në rastin e mbylljes së muzeve privatë;
- o) Njofton pronarët ose poseduesit për fillimin e procedurës së mbrojtjes indirekte;
- p) Kryen kontrolle për zbatimin e detyrimeve ligjore lidhur me hapjen dhe shfrytëzimin nga publiku të pasurive kulturore, respektimin e kushteve të përcaktuara në aktin e tjetërsimit dhe detyrime të tjera të parashikuara në ligj;
- q) Kryen verifikimet e nevojshme në terren dhe i përcjell zyrtarisht IKTK-së informacion në rastin e gjetjeve të konstatuara nga vetë DRTK-ja ose të tjerë mbi bazën e konstatimeve ose të deklarimeve të marra për gjetje rastësore arkeologjike në territor ose gjatë zbatimit të projekteve;
- r) Jep mendim lidhur me përputhshmërinë e vendosjes dhe të llojit të reklamimit me vlerat e peizazhit të ndërtimeve apo zonave, subjekt i mbrojtjes;
- s) kryen çdo funksion tjetër të parashikuar me ligj.

KREU III

DREJTIMI, MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT DHE DETYRAT E DREJTORIT

Neni 9

Drejtimi

1. Drejtori i DRTK Vlorë emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
2. Bazuar në vendimin nr. 173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave *“Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit”*, drejtori emërohet sipas procedurës së mëposhtme:
 - a) ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, urdhëron të paktën 15 ditë përpara datës së emërimit, shpalljen në media të vendit të lirë;
 - b) kandidatët e paraqitur, krahas kërkesave të përgjithëshme për t’u punësuar në shërbimin civil, sipas nenit 12 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 *“Statusi i nëpunësit civil”*, duhet të plotësojnë edhe kërkesat e veçanta, të cilat jepen në shpalljen në media të vendit të lirë
 - c) ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore përzgjedh dhe emëron njërën nga kandidaturat e paraqitura që plotëson kërkesat e mësipërme.
3. Drejtor emërohet personi që ka arsim të lartë në një fushë të përshtatshme me funksionin si Drejtor i DRTK-së Vlorë dhe për ushtrimin e kompetencave të DRTK-së, Vlorë, me detyrat si më poshtë vijon:

- a) planifikon, drejton dhe koordinon funksionimin e përgjithshëm të institucionit;
- b) harton në bashkëpunim me sektorët dhe zbaton objektivat dhe planin e punës të DRTK-së Vlorë, në përputhje me misionin e saj dhe me politikën, strategjinë dhe objektivat e Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
- c) Drejton veprimtarinë dhe praktikën administrative të institucionit dhe përfaqëson DRTK Vlorë në marrëdhënie me të tretët;
- d) Mbikëqyr dhe menaxhon efektivitetin e sektorëve dhe burimeve njerëzore;
- e) Bashkërendon proceset e punës të sektorëve dhe orienton veprimtaritë kualifikuese me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale të personelit të DRTK Vlorë;
- f) Emëron dhe shkarkon punonjësit e institucionit në përputhje me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar;
- g) nënshkruan marrëveshje me institucione dhe organizata vendase dhe të huaja pas miratimit në parim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore që synojnë bashkëpunim të ndërsjellët, projektet dhe aktivitete të përbashkëta si dhe shkëmbime dhe kualifikime të personelit.

Neni 10

Funksionet e Sektorëve

1. DRTK Vlorë është organizuar në Sektorë si më poshtë vijon:
 - a) Sektori i Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore;
 - b) Sektori i Financës dhe shërbimeve Mbështetëse;
 - c) Sektori i Sarandës
 - d) Sektori i Himarës;
 - e) Sektori i Parqeve Amantia-Orikum-Finiq-Antigonea;
 - f) Sektori i Fierit.
2. Sektorët drejtohen nga përgjegjësit e sektorëve të cilët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e veprimtarisë së sektorit dhe përmbushjen e detyrave të tij dhe kryejnë këto funksione:
 - a) planifikojnë, mbikëqyrin dhe koordinojnë veprimtaritë në sektor, në përputhje me planifikimin vjetor;
 - b) propozojnë në bashkëpunim me sektorin dhe zbatojnë objektivat dhe planin e punës të sektorit-së në përputhje me misionin e DRTK dhe me politikën, strategjinë dhe objektivat e Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
 - c) mbikëqyrin dhe menaxhojnë efektivitetin e sektorit;
 - d) bashkërendojnë proceset e punës brenda sektorit dhe orientojnë veprimtaritë kualifikuese me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale në përputhje me nevojat e sektorit.
3. Sektorët janë përgjegjës dhe kryejnë këto funksione:
 - a) Sektori i Sektorit i Arkeologjisë, Arkitekturës, Artit dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore është përgjegjës për ruajtjen, mirëmbajtjen, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale në Bashkinë Vlorë, Bashkinë Sarandë dhe Bashkinë Himarë.

- b) Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjës për menaxhimin e financave dhe burimeve njerëzore dhe garantimin e zbatimit të kuadrit ligjor për të gjithë procedurat e lidhura me veprimtarinë e DRTK Vlorë.
- c) Sektori i Sarandës është përgjegjës për ruajtjen, mirëmbajtjen, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale në Bashkinë Sarandë.
- d) Sektori i Himarës është përgjegjës për ruajtjen, mirëmbajtjen, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale në Bashkitë Himarë.
- f) Sektori i Parqeve Amantia-Orikum-Finiq-Amantia është përgjegjës për mbrojtjen administrimin dhe mirëmbajtjen e Parqeve Orikum- Finiq, për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe asaj natyrore, sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- g) Sektori i Fierit është përgjegjës për ruajtjen, mirëmbajtjen, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale në Bashkitë Fier.

Neni 11

Marrëdhëniet e punësimit

1. Punësimin në DRTK Vlorë bëhet me kontratë individuale pune në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, që rregullon marrëdhëniet e punës.
2. Rregullimi i marrëdhënieve të punës për sa i përket vlerësimit të performancës, përshkrimit individual të punës, shkeljet dhe masat disiplinore, përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të DRTK Vlorë.
3. DRTK Vlorë vendos marrëdhëniet e punës me punonjësit përmes kontratave me afat të pacaktuar dhe me kohëzgjatje të caktuar, sipas nevojave administrative institucionale.
4. Rregullimi i marrëdhënieve të punës për sa i përket vlerësimit të performancës, përshkrimit individual të punës, shkeljet dhe masat disiplinore, përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të DRTK Vlorë.
5. Afatet dhe procedurat e njoftimit referuar përcaktimeve të Kodit të Punës dhe Kodit të Procedurave Administrative, për çdo rast dhe natyrë të shkeljeve disiplinore, janë si më poshtë:
 - a) Njoftimi për ecurinë disiplinore dhe zhvillimit të seancës dëgjimore i drejtohet me shkrim punonjësit të paktën 72 orë përpara datës së caktuar për takim. Njoftimi drejtohet në vendin e punës ose në adresën e vendbanimit;
 - b) Seanca dëgjimore realizohet në prani të Drejtorit, përfaqësues nga Sektori i Shërbimeve Mbështetëse;
 - c) Gjatë seancës dëgjimore Drejtori, parashtrohet punonjësit arsyet e vendimit për fillimin e ecurisë disiplinore konkrete dhe të vërtetuar dhe i jep atij mundësinë për tu shprehur;
 - d) Vendimi për dhënien e masës disiplinore njoftohet me shkrim brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit.

KREU IV

ADMINISTRIMI FINANCIAR

Neni 12

Të ardhurat buxhetore

1. DRTK Vlorë është institucion buxhetor shtetëror në varësi të Ministrisë së Kulturës.
2. Fondi për buxhetin e DRTK Vlorë miratohet nga Ministri i Kulturës, pas miratimit në Kuvendin e Shqipërisë të ligjit për buxhetin vjetor.
3. Të ardhurat buxhetore krijohen dhe administrohen nga DRTK Vlorë sipas legjislacionit në fuqi: Vendimit nr. 432, dt. 28.06.2006 *"Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore"* si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Financës.
4. DRTK Vlorë, në kuadër të realizimit të projekteve për trashëgiminë kulturore, mund të marrë donacione dhe sponsorizime të ndryshme nga subjekte private ose organizata të ligjshme, shqiptare apo të huaja, në respektim të kuadrit ligjor në fuqi.
5. Fondet vjetore të akorduara nga buxheti i shtetit si dhe çdo e ardhur e realizuar nga sponsorizimet, donacionet etj., do të nënshtrohen procedurës së prokurimit publik.

Neni 13

Hartimi i projekt buxhetit

DRTK Vlorë, në tre mujorin e parë të çdo viti kalendarik, paraqet pranë Ministrisë së Kulturës, projekt buxhetin afatmesëm të shpenzimeve dhe të investimeve për vitin pasardhës, të shoqëruar me preventivat përkatës.

Neni 14

Auditimi i DRTK Vlorë

Administrimi dhe veprimtaria financiare e DRTK Vlorë, auditohen nga Ministria e Kulturës si dhe institucione të tjera të ngarkuara me ligj për auditim.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Propozimi dhe ndryshimet në statut

1. Statuti i DRTK Vlorë propozohet nga titullari i DRTK Vlorë dhe miratohet nga Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
2. Ndryshimet dhe plotësimet në këtë Statut propozohen nga titullari i DRTK Vlorë dhe miratohen nga Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky statut hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.